



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK FIER

Nr. 5118/ Prot.

2

Fier, më 04.05.2026

VENDIM

Nr. 39, datë 30.04.2026

**“Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Sazan Allajbeu, fshati Portëz, Njësia Administrative Portëz, i dëmtuar nga zjarri i datës 12.03.2026.”**

Në mbështetje të nenit 3, pikës 1.1 të nenit 9, dhe nenit 29 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 **“Për Vetëqeverisjen Vendore”** (i ndryshuar), nenit 30 dhe 41 të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 **“Për Mbrojtjen Civile”**, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 **“Për financat e vetëqeverisjes vendore”**, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Fier nr.118, datë 11.12.2025 **“Për miratimin e buxhetit të vitit 2026”** si dhe në zbatim të shkronjave “e” dhe “ë” të pikës 1, të paragrafit III, të V.K.M-së Nr.329 datë 16.05.2012 **“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”**, kreu III pika 1, për dëmin e shkaktuar nga zjarri i datës 12.03.2026, shkresës zyrtare nr.307/1.prot, datë 08.04.2026 **“Vlerësim dëmi”** të Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Zhvillimit të Projekteve, Këshilli i Qarkut Fier, si dhe Preventivit bashkëlidhur kësaj shkrese, ku ka rezultuar se në banesën e shtetasit Sazan Allajbeu dëmi në orëndi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake është në vlerën **158 300 (njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tre qind) lekë** dhe në anën ndërtimore në vlerën **235 889 (dyqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë**, ndaj bazuar në nenin 30, shkronja“gj”, e ligjit 45/2019, Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Për sa më sipër, Këshilli Bashkiak Fier,

VENDOSI:

1. Dhënie e ndihmës financiare prej Bashkisë Fier për shtetasin Sazan Allajbeu, në masën **100%**, për dëmet e shkaktuara në orëndi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake, në vlerën prej **158 300 (njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tre qind) lekë**.
2. Dhënie e ndihmës prej Bashkisë Fier në masën **50%**, për dëmet e shkaktuara në anën ndërtimore të banesës, në vlerën prej **117 944 (njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzetë e katër) lekë**, konform përcaktimeve ligjore të pikës 3, gërmës “ç” **“Përcaktimi i ndihmës financiare”** e VKM nr.329 datë 16.05.2012.

3. Vlera totale financiare e dhënies së ndihmës sipas pikave 1 dhe 2 të këtij projekt vendimi për shtetasin Sazan **Allajbeu** është në masën **276 244 (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzetë e katër) lekë.**

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile si dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

5. Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I KËSHILLIT**  
**MELSI BOGDANI**

